



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA



Pranuar - Prinjeno Mbi/Dana <b>12-03-2020</b>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Satë/ës Prilog	Vlera Vrednos*
<b>01-070/03-264</b>			

Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 36, paragrafi 2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 12.03.2020, miraton këtë:

## DEKLARATË

Kuvendi Komunal i Vitisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 12.03.2020, lidhur me moskyqjen e Komunës së Vitisë në autostradën "Arbër Xhaferi" në Gërlicë, shpreh shqetësimin dhe pakënaqësinë e tij, në përfaqësuesit e partive politike, në emër të gjithë qytetarëve të komunës sonë, nëpërmjet kësaj deklarate drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë për Infrastrukturë, kërkojmë që të adresohet kërkesa dhe nevoja e qytetarëve të Komunës së Vitisë për mundësimin e kyçjes në autostradën "Arbën Xhaferi".

Nisur nga arsyeshmëria e kërkesës dhe nevojës së madhe të qytetarëve, Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë, miraton këtë deklaratë, përmes të cilës kërkon, që Qeveria e Republikës së Kosovës, të modifikojë projektin me qëllim të zhblokimit të banorëve të Komunës së Vitisë dhe të u mundësojë qasje në Autostradën "Arbër Xhaferi".

**Kërkojmë** nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta planifikon në projekt buxhetin e Qeverisë së Kosovës për vitin 2020, koston buxhetore për kyqjen e Komunës së Vitisë në autostradën "Arbër Xhaferi" në Gërlicë. Kjo kërkesë përfaqëson vullnetin e mbi 50 mijë qytetarëve të Komunës së Vitisë.

KRYESUES I KUVENDIT

Naim Pira



Ali Bajrami Shef i GP të LDK-së

Mirlinda Sadiku Shefe i GP të LVV-së

Bekim Azizi Shef i GP të PDK-së

Vehbi Rama Shef i GP të AAK-së

Viti, më 12.03.2020